



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:112575

Datë: 27.11.2023

Numri i dokumentit: 04977311

P.nr.1765/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dibran Jusufi dhe bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.M., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.6751/17 të datës 22.05.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 22.11.2023, të hapur për publikun, në prani të prokurores së shtetit Vjosa Bytyqi, të akuzuarit A.M. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. H.C. dhe të dëmtuarës S.H., me datë 24.11.2023 morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 27.11.2023 me shkrim e përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari A.M., nga babai N..., dhe nëna B..., e gjinisë B..., i lindur me datë, në Prishtinë, me vendbanim në lagjennr....., ..., i pa martuar, i punësuar si shpërndarës në Burger King, ka të përfunduar shkollën e mesme, me gjendje të dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 02.11.2017 rreth orës 18:30 në rrugën Podujevë-Prishtinë, më saktësisht tek shkolla fillore “Ilmi Rakovica” në Prishtinë, i pandehuri A.M., ka vepruar në kundërshtim me ligjin mbi Rregullat për trafikun rrugor (neni 53 dhe 149) nga pakujdesia, duke menduar me mendje lehtësi se deri të aksidenti nuk do të vij, ka rrezikuar komunikacionin dhe ka vu në rrezik jetën e njerëzve, ka qenë duke drejtuar automjetin “.....” ngjyrë hiri me targa, dhe për shkak

të lëshimeve nga pakujdesia, duke mos përshtatë shpejtësinë e lëvizjes së automjetit me kushtet e krijuara në komunikacion e godet këmbësoren tani të dëmtuarën S.H.n, e cila ka pësuar lëndime trupore të cilat janë kualifikuar si lëndime të rënda trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin,

-Me këtë i pandehuri e ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së,

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 73, 74 dhe 75 të KPRK-ës dhe neneve 242 e 364 të KPP-ës, të akuzuarin:

E GJYKON

I. Me dënim me burgim prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit konform nenit 47 të KPRK-së, shndërrohet në dënim me gjobë në shumë prej 800 € (tetëqind euro) i cili dënim do të ekzekutohet me dy këste, duke filluar brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, e pastaj çdo fillim të muajit nga data 1 deri me datën 5 të muajit përkatës.

II. Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

III. E dëmtuara S.H. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil

IV. Obligohet i akuzuari i lartcekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € (njëzet euro) dhe shumën prej 20 € (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

-Rrjedha e procedurës penale-

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 27.05.2019, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën me numër PP/II.nr.6751/2017 të datës 22.05.2019, kundër të akuzuarit A.M. nga Prishtina, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së,

Me datë 22.11.2023, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Vjosa Bytyqi, i akuzuari A.M. me mbrojtësin sipas autorizimit av. H.C. dhe e dëmtuara S.H.. Në këtë seancë prokurorja e shtetit ka lexuar aktakuzën lëndore, me ç ‘rast i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë me ç ‘rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 të KPPRK-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarit.

-Vlerësimi i pranimi të fajësisë-

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 242 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza, e po ashtu me rastin e pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

-Gjendja faktike e vërtetuar-

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe se në

veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të kësaj vepre penale.

-Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit-

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-së. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin dhe që të akuzuarit i ka shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë me ligj, gjykata po ashtu si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, se i njëjti është penduar, moshën relativisht të re, i vjen keq për rastin dhe ka premtuar se nuk do të përsërisë më veprime të tilla, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin si dhe gatishmërinë e shprehur për kujdes dhe ndihmë ndaj palës së dëmtuar ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk është së gjeti ndonjë. Duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ë gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 462 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarën e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko-civil.

-Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale-

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së. Ndërsa, për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr komfor nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1765/19 , me datë 27.11.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues
Dibran Jusufi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.